

Pagesat e pacientëve

Fëmijët dhe adoleshentët deri në 19 vjeç nuk paguajnë për kujdesin shëndetësor. Megjithatë, kjo nuk zbatohet për barnat, raportet dhe vaksinat me përjashtim të programit të përgjithshëm të vaksinimit për fëmijët.

Vizitat tek doktorët

Vizitat tek punonjësit mjekësor të rrethit në qendrën shëndetësore	150:-
Shtesa për vizita në shtëpi	0:-
Vizitat tek doktorët në qendrat e urgjencës ose të ngjashme	300:-
Vizitat tek doktori në spital ose me specialistët privatë (të financuar nga shteti)	300:-
Vizita e parë me specialistin pas dërgimit nga doktori i qendrës shëndetësore	150:-
Kujdes ditor me vizita nga doktori, pa përfshirë ushqimin	300:-
Recetat/këshillat në telefon nga doktori	100:-

Trajtime të tjera shëndetësore

Vizita tek infermierja në qendrën shëndetësore, spital e brenda pavijonit psikiatrik	100:-
Recetat në telefon	100:-
Kujdes paralindjes për nënat shtatzëna ose kujdes shëndetësor për fëmijën	0:-
Vizitat me fizioterapistin, terapistin e të folurës, terapistin profesional, psikologun, etj	100:-
Testimi i pajisjeve ndihmëse	0:-
Trajtimet në grup të tilla si ushtrimet në pishina, ushtrimet në grup për zemrën	50:-
Grafi në të njëjtën ditë me vizitat e tjera në spital	0:-
Ekzaminim me grafi pas dërgimit nga një qendër shëndetësore	150:-
Ekzaminim me grafi pas dërgimit nga një specialist, jo të njëjtën ditë	300:-
Analiza që nuk janë pjesë e një vizite tjetër	100:-
Kujdes ditor, që nuk përfshin ushqimin	100:-

Masat/trajtimet që nuk janë të lidhura me sëmundjet

Mamografi	200:-
Kontroll i kampioneve të qelizave gjinekologjike, pas vizitës	100:-

Kontroll i kampioneve të qelizave gjinekologjike, me kërkesë personale

200:-

Vaksinimet, raportet, etj.

Pagesat ndryshojnë në vartësi të llojit të vaksinimit dhe raportit. Vaksinimet për gripin dhe pneumokokusin, e për grupet më të rrezikuara janë pa pagesë.

Pagesat për ushqimin gjatë kujdesit ditor

Dreka

54:-

Dreka e lehtë

39:-

Pagesat e spitalit

Nëse duhet të shtroheni në spital duhet të paguani SEK 80 për ditë nën kujdes. Kjo zbatohet për të gjithë ata që janë 20 vjeç e sipër.

Pagesat e reduktuara

Nëse merrni kujdes shëndetësor të vazhdueshëm pagesa juaj reduktohet nga dita e 91-të e kujdesit.

Nëse merrni kujdes për më shumë se 100 ditë gjatë një periudhe 12 mujore keni të drejtën që të paguani një pagesë të reduktuar për ditët pasardhëse të kujdesit.

Nëse të ardhurat tuaja ose pensioni janë më të ulët se SEK 80 000 në vit mund të keni të drejtën të paguani pagesë të reduktuar.

Nëse jeni nën moshën 40 vjeç dhe merrni ndihmë sociale të plotë ose kompensim për sëmundje keni të drejtën të paguani pagesën e reduktuar për 30 ditët e para të çdo lloj periudhe nën kujdesin shëndetësor.

Ju duhet të bëni kërkesë për pagesat e reduktuara. Kërkojini ndihmë personelit të kujdesit shëndetësor.

Pagesa e drejtpërdrejtë

Ju mund të paguani duke përdorur para në dorë ose kartë krediti. Nëse doni një faturë atëherë duhet të paguani dhe pagesën shtesë prej SEK 50.

Kufiri i pagesës maksimale

Asnjë pacient nuk duhet të paguajë më shumë se SEK 900 për kujdesin shëndetësor brenda një periudhe dymbëdhjetë mujore. Pasi të keni paguar SEK 900 ju jepet një kartë (për shërbim) falas. Ju mund të përfshini në të pagesat si për kujdesin shëndetësor të ofruar nga Bashkia e Rrethit ashtu dhe kujdesin shëndetësor të financuar privatisht. Mund të përfshini edhe pagesat paguar Bashkive të Rretheve të tjera.

Pagesat mund të përfshihen në kufirin e pagesës maksimale. Pacienti vetë duhet të sigurohet që kartat e tyre të vulosen dhe t'i ndjekin se kur arrijnë masën kufi prej SEK 900.

Nuk përfshihen në kufirin maksimal të pagesave:

- Pagesat e paguara kur jeni shtruar në spital
- Pagesat personale për pajisjet ndihmëse
- Vaksinimet
- Raportet
- Masat ose trajtimet që nuk kanë të bëjnë me sëmundjen

- Vizitat që nuk janë kryer

SEK 1800 për barnat

Asnjë pacient nuk duhet të paguajë kurrë më shumë se SEK 1800 gjatë një periudhe prej dymbëdhjetë muajsh për barnat. Pasi të keni kaluar kufirin prej SEK 1800 ju do të merrni një kartë falas.

Fëmijët dhe adoleshentët deri në 18 vjeç dhe ata që i përkasin të njëjtës familje mund t'i kombinojnë kostot e barnave të tyre.

Për barnat ju paguani gjatë periudhës dymbëdhjetë mujore:

Kostoja e kombinuar në SEK	Përqindja juaj	Maksimumi që paguani
-900	100 %	-900
900-1 700	50%	900-1 300
1 700-3 300	25%	1 300-1 700
3 300-4 300	10%	1 700-1 800
4 300-	0%	1 800

Në rast se keni pyetje kontaktoni farmacistin tuaj.

Nëse nuk paraqiteni në vizitë

Nëse nuk vini dot në një vizitë duhet të anuloni vizitën të paktën 24 orë përpara në mënyrë që dikush tjetër ta përdorë këtë orar vizite. Nëse nuk e anuloni mund t'ju duhet të paguani pagesën për vizitën plus një faturë shtesë prej SEK 50.

Nëse ju bëjnë të prisni

Nëse ju duhet të prisni më shumë se 30 minuta pas orarit të caktuar të një vizite ju në përgjithësi keni të drejtën të rimbursoheni për pagesën e vizitës. Kontaktoni personelin e kujdesit shëndetësor.

Nëse vizita ose trajtimi anulohen

Nëse një operacion, ekzaminim ose trajtim i planifikuar anulohen ju mund të keni të drejtë e një lloj kompensimi për çdo shpenzim që mund të keni paguar. Nuk do të jepet kompensim në rast aksidentesh ose urgjencash të papritura.

Shërbimi ndaj klientëve:

Keni pyetje në lidhje me faturën tuaj? Shërbimet ndaj klientit Landstingets mund t'ju ndihmojnë me pyetjet që kanë të bëjnë me faturat dhe pagesat. Ju mund të merrni ndihmë edhe për kufirin maksimal të pagesave dhe kartat falas.

Mund të na kontaktoni në numrin: 0470-58 96 50.